

**VENDIM**  
**Nr. 452, datë 15.6.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërbli-meve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërbli-met e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1/3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

i) Në shkronjën "a", emërtesa "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" zëvendësohet me "Agjencia e Trajtimit të Pronës".

ii) Në shkronjën "b" shtohet emërtesa "Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi".

iii) Në shkronjën "c", emërtesa "Fototeka Kombëtare Marubi" shfuqizohet.

b) Në fund të pikës 4/1 shtohet shprehja "inxhinieri matematike informatike".

c) Në pikën 6, fjalët "Titullari i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ..." zëvendësohen me "Titullari i Agjencisë së Trajtimit të Pronës ...".

ç) Lidhja nr. 9/4, që përmendet në pikën 13/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:

- për Agjencinë e Trajtimit të Pronës dhe Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi" të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve/puno-njësve në detyrë dhe të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2016;

- për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale të fillojnë nga data 15 prill 2016 dhe të përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion për vitin 2016;

- për përcaktimin e shkronjës "b", të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 janar 2016 dhe të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Zyrat (Drejtoritë) Rajonale, të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale**

| <b>POZICIONI</b>                                                                                                                                                                      | <b>KATEGORIA</b> | <b>KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT</b> | <b>SHTESA PËR KUSHTE PUNE</b> |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|
| Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t:<br>Tirana Veri , Tiranë Jug, , Tirana (2), Zonat Turistike Tirana Rurale, Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës, Lezhë, Vlorë, Elbasan, Fier, Korçë, Berat | III-a/1          | 1                                                                                                                          | 16.500                        |
| Drejtor i drejtorive të ALUIZNI-t:<br>Kavajë, Sarandë, Lushnje, Krujë, Gjirokastër, Dibër, Kukës                                                                                      | III-b            | 1                                                                                                                          | 16.500                        |
| Përgjegjës Sektori .                                                                                                                                                                  | IV-a             | 1                                                                                                                          | 10.000                        |
| Specialist .                                                                                                                                                                          | IV-b             | 1 ose 2 ose 3                                                                                                              | 10.000                        |